



Qengji i Kurbanit

Ylli H. Doçi

QENGJI I KURBANIT

Reflektim mbi domethënien e ritualit të kurbanit

Ylli H.Doçi

QENGJI I KURBANIT

*Reflektim mbi domethënien
e ritualit të kurbanit*

BOTIMET
Jeta e Re 

Ylli H.Doçi

Qengji i Kurbanit

Reflektim mbi domethënien e ritualit të kurbanit

ISBN: 978-99956-851-0-2

Kopertina: Engjëlli ndalon Abrahamin në sakrifikimin e Isakut. 1635. (Kanavacë 193 x 133 cm, Leningrad, Hermintage. Rembrandt van Rijn (1609-1969))

BOTIMET 
Jeta e Re

Shtypur në Tiranë. Tiražhi: 2000 kopje

*Ia kushtoj këtë libër,
mikut tim kompozitor, Pëllumb Vorpsi,
mysliman i përkushtuar,
si një bashkëbisedues rreth të vërtetës.*

Përmbajtja

Parathënie	9
Hyrje	15
<i>E vërteta dhe ngatërrimi me fenë</i>	15
<i>Kërkuesi i së vërtetës</i>	19
<i>Tri ngjarje sqaruese</i>	21
1. Festa e Kurban Bajramit	23
<i>Një detaj i pavlerësuar i një historie të njohur</i>	23
<i>Origjina e çështjes së kurbanit</i>	25
<i>Jeta si bashkëmiqësi me Perëndinë</i>	26
<i>Vdekja si ndarje</i>	29
<i>Mëkati si shkak i vdekjes</i>	30
<i>Kurbani si përkujtimore e dashurisë</i>	31
<i>Kurbani si shenjë e shpëtimit për të gjithë brezat</i>	33
<i>Mëkati si sëmundje</i>	36
<i>Mëkati si krim</i>	37

QENGJI I KURBANIT

<i>Të gjithë jemi mëkatarë</i>	40
<i>Paradoksi i drejtësisë dhe dashurisë</i>	42
2. Lindja e Jezuit dhe Kurbanit	45
<i>Shpjegime të pamjaftueshme të Krishtlindjes</i>	46
<i>Domethënia e lindjes nga virgjëresha</i>	47
3. Kryqi dhe Kurbanit	49
<i>Historia si monument asnjëanësie</i>	50
<i>Turpi i kryqit është i rëndë</i>	51
<i>Kuptimi që nuk erdhi nga arsyetimi</i>	53
<i>Kuptimi që i qëndron edhe arsytimit</i>	54
<i>Çështja e palës së tretë</i>	55
<i>Kuptimi që kërkon besim personal</i>	57
<i>Pashmangshmëria e përgjigjes</i>	58
Pasthënie	60
Për ndihmë të mëtejshme	62

Parathënie

Tashmë u mbushën 19 vjet që nga koha kur unë kam kuptuar të vërtetën e rëndësishme që ky libër përpiqet të tregojë. Kjo ka shkaktuar një furtunë transformuese në jetën time, duke më sjellë në disa brigje që nuk e dija se ekzistonin.

Asokohe isha i dorëzuar ndaj artit si preokupimi më i madh i jetës sime dhe kurrë nuk do më kishte shkuar mendja që do ta ndërroja skulpturën me diçka tjetër si preokupimin tim parësor në këtë jetë. Me artin dhe veçanërisht me vizatimin, pikturën dhe skulpturën, isha familjarizuar qysh në shkollë fillore, falë një jete aktive artistike në qytetin tim të lindjes në Burrell, ku rreth

viteve '80 ushtronin aktivitetin e tyre shumë artistë figurativë. Një nga profesorët e Akademisë së Arteve dhe miqtë e mi më të mirë, skulptori Fatos Kola, akoma ka shpresë që unë do të kthehem te skulptura si te dashuria e parë. Edhe unë e pres me gëzim atë kohë. Por tani jam si ai fëmija që s'ngopet dot me lodrën e re që ka marrë dhuratë. Ashtu si një fëmijë që mund të jetë i sigurt se do bëhet shofer apo zjarrfikës kur të rritet, por pastaj mahnitet me mjekësinë dhe bëhet doktor, është e kuptueshme edhe historia ime, po të merrni seriozisht përmbajtjen e këtij libri të vogël.

Sot, në vend të skulpturës dhe formësimit të hapësirave fizike, unë ndihmoj me formësimin e karaktereve dhe zemrave njerëzore. Kjo mund të duket tepër poetike dhe arrogante, por ju nuk më keni dhënë akoma kohë të shpjegohem e të them se unë jam thjesht një ndihmës i një skulptori të madh të zemrave njerëzore, Jezuit. Kam frikë se sapo e thashë këtë emër ju më keni futur në ndonjë nga kategoritë e njerëzve që i keni

gati në mendjen tuaj, p.sh. “Oh, qenka fetar!” Kjo më ka bërë për të qeshur një herë kur më kishin ftuar në “Top Show” në lidhje me çështjen komplekse të klonimit dhe më prezantuan si “përfaqësues i fesë”.

Unë nuk jam fetar. Unë nuk jam skllav i asnjë feje. Unë jam dorëzuar vetëm si skllav i të vërtetës, e cila nuk është çështje fetare më shumë se ç’është çështje filozofike, më shumë se ç’është çështje praktike jetësore, siç kuptohet normalisht e vërteta nga të gjithë njerëzit normalë. Unë jam i përkushtuar ndaj së vërtetës kudo që ajo të më çojë, në çfarëdo brigjesh apo caku të paimagjinuar më parë, edhe pse nuk jam gjithmone i suksesshëm në arritjen e idealit tim në çdo rast.

Në fakt, e vërteta është edhe fokusi i këtij libri të vogël. Më saktë, e vërteta thelbësore e jetës njerëzore që është një e vërtetë kaq befasuese, kaq e pabesueshme, kaq e thjeshtë dhe tronditëse, sa mund të sjellë revolucion në çdo jetë njerëzore me pasoja të mrekullueshme.

Unë e shkrova variantin e parë të këtij libri rreth vitit 1996, si një përpjekje për të shpjeguar disa koncepte që i kisha formuar në rrjedhën e kuptimit tim të kësaj së vërtete të çuditshme. Nga leximet e mia, nga bisedat me shumë njerëz u kristalizuan pak çështje kyçe që keqkuptoheshin jo me dashakeqësi.

Qysh nga fillimi, kur unë kam organizuar mendimet e mia pak a shumë në këtë formë që gjenden në këtë libër, kam biseduar me qindra njerëz, shumica prej tyre myslimanë, dhe kam vërtetuar se këto koncepte të krahasuara dhe të shpjeguara shkurt mjaftojnë për të hedhur bazën e një bashkëbisedimi inteligjent në lidhje me çështjen më të rëndësishme të jetës dhe ekzistencës njerëzore.

Nga gjërat më të trishtueshme për mua është që njerëz të sinqertë e pasionantë për të vërtetën nuk merren dot vesh me njëri-tjetrin, sepse mendojnë se të kuptohesh me tjetrin duhet të biesh dakord me tjetrin apo të besosh atë që beson tjetri. Unë jam i bindur se, edhe pas leximit të këtij libri,

shumë njerëz nuk do bien dakord me mua në shumë gjëra. Në fakt, unë ia kushtoj këtë libër një mikut tim që nuk bie dakord me mua në disa gjëra të rëndësishme në këtë libër, por dëshira ime është thjesht të kuptojmë njëri-tjetrin, të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të lejojmë mendjen tonë ta shikojë çështjen sipas këndvështrimit të bashkëbiseduesit tonë sa për ta marrë vesh çfarë po thotë dhe pse është kaq i pasionuar për këtë gjë.

Asnjë njeri nuk ka monopolin mbi të vërtetën apo di gjithçka për të vërtetën. Të gjithë jemi bashkudhëtarë në një botë ku e vërteta zbulon vetveten dhe as nuk shpiket nga dikush e as mund të asgjësohet nga askush, prandaj le të ulemi e të bisedojmë si miq e pastaj të vazhdojmë në rrugën tonë në këtë botë të mahnitshme ku ka vend për të gjithë.

Tiranë, 31 dhjetor 2009

Hyrje

E vërteta dhe ngatërrimi me fenë

Thonë se gjatë një mbrëmjeje në një turne koncertal në Gjermani, Xhimi Hendriks (Jimi Hendrix) i befasoi të gjithë admiruesit e tij. Ndërsa njerëzit hidheshin e bërtisnin, këndonin e tundeshin, rrihnin shuplakat e mbyllnin sytë në kënaqësitë e imagjinuara nga muzika dhe influenca të tjera të brendshme e të jashtme të asaj mbrëmjeje, dikush tha me zë të lartë, çuditërisht të qartë: “Xhim, ti je e vërteta!” Xhimi bëri shenjë që muzika të ndalojë dhe u kthye me shumë seriozitet andej nga erdhi zëri.

- “Çfarë the?” - pyeti Xhimi, sikur të ishte duke pritur një lajm të rëndësishëm.

- “Ti je e vërteta, Xhim!” përsëriti zëri, duke pritur aprovimin e idhullit të tij. Por Xhimi Hendriks tha se ai nuk ishte e vërteta, për kaq gjë ishte i sigurt, por nëse dikush e dinte se kush ishte e vërteta, iu lut t’ia thoshin. Unë mund ta imagjinoj heshtjen që pasoi, zhgënjimin e idhujtarëve në atë sallë, por edhe zhgënjimin e Xhimit që nuk mori përgjigje nga askush për pyetjen: “Cila është e vërteta?” Pas kësaj klithme të fundit për të vërtetën, zemra e Xhimit pushoi së rrahuri nga vetëvrasja që bëri pak kohë pas kësaj ngjarjeje.

Një gjë është e sigurt: njeriu s’mund të jetojë i lumtur pa të vërtetën ose të paktën pa menduar se ka të vërtetën, prandaj ia ka borxh vetes të sigurohet me aq sa ka mundësi se cila është e vërteta. Kur flitet për të vërtetën në këtë mënyrë, sikur të ishte çelësi i arsyes së ekzistencës, njerëzit me të drejtë e “ngatërrojnë” çështjen me fenë. Feja është

një diçka e vështirë për t'u përkufizuar mjaftueshëm në këtë libër të vogël, prandaj duhet një libër tjetër, por arsyeja pse unë e quaj “ngatërrim” kërkimin e së vërtetës të feja është për arsyen se feja është një prodhim njerëzor, sado i sinqertë dhe besnik qoftë ky prodhim ndaj zbulesës hyjnore të pretenduar nga praktikuesit e saj. Pra, e vërteta nuk duhet ngatërruar me besimin e një feje të caktuar. E vërteta ka shumë dimensione dhe mund të gjendet në çdo hapësirë njerëzore dhe nga çdokush. E vërteta është një dritë që mund të shihet nga çdo sy njerëzor, pavarësisht në çfarë vathe fetare ose jo fetare e gjen veten.

Nga ana tjetër, mendoj se njerëzit kanë të drejtë ta kërkojnë të vërtetën në rrethinat e fesë, sepse feja nuk është krejtësisht apo në të gjitha rastet një përrallë pa lidhje me realitetin objektiv të ekzistencës sonë. Gjithashtu, ndoshta më shumë se format e tjera të shpjegimeve njerëzore, shpjegimet fetare kanë brenda tyre shprehje të koncentruara të shqetësimit më kuptimplotë

të njeriut. Preokupimi njerëzor për të vërtetën gjen një burim të ligjshëm dhe inteligjent të feja. Janë të keqinformuar dhe të indoktrinuar ata që nuk e kuptojnë të paktën kaq vlerë të feja, ky prodhim kaq jetëgjatë i racës njerëzore.

Me këtë libër unë shpresoj të bashkëbisedoj me ata që e kanë kaluar pragun e pranimi të fesë si një bashkudhëtare e mirëpritur e njeriut edhe në shekullin e XXI. Megjithatë, biseda jonë nuk ka pse të bëhet e pakuptueshme për ata që duan të hyjnë në këtë bisedë tani për herë të parë, por duhet të mbajnë parasysh që diskutimi ynë lidhet me disa kuptime të ndryshme midis myslimanëve dhe të krishterëve për një çështje shumë të përfolur dhe pak të kuptuar siç është sakrifica ose më specifikisht, kurbanit.

Kërkuesi i së vërtetës

Kur një besimtar në të mbinatyrshmen takon një tjetër besimtar të tillë, menjëherë ndjen një afërsi që natyrshëm supozon një kuptim të ngjashëm për realitetin, por, pa kaluar shumë kohë ndërsa bisedojnë, mund të shohësh që janë larg si nata me ditën. Shumë njerëz pyesin se si ka mundësi që besimtarë të sinqertë duke u përpjekur të kuptojnë të vërtetën me ndershmëri, të kenë pikëpamje kaq të ndryshme për Zotin dhe Rrugën e Tij. Në fakt, Zoti ka folur dhe e vërteta është e zbuluar në botë. Ai ka siguruar dritë të mjaftueshme që njerëzit ta dallojnë. Sidoqoftë, vetëm atyre që janë të përkushtuar të kërkojnë të vërtetën pa kompromis, ta pranojnë fjalën e Tij, ta hapin edhe zemrën ndaj kuptimit, atyre që luftojnë për thellësi kuptimi, atyre që e kërkojnë si argjendin, që gërmojnë si për një thesar të fshehur, atyre mençuria do t'ua gjejë derën e zemrës dhe

njohuria do të jetë e shijshme për shpirtin e tyre. Zoti premton se atëherë ata do të arrijnë njohjen e Tij dhe do të kuptojnë frikën e Zotit.

Duke qenë nga një familje me traditë myslimane, ishte e vështirë për krenarinë time që të vihesha përballë kuptimit të krishterë për disa çështje në lidhje me myslimanizmin që mendoja se i dija. Besoj që unë nuk jam i vetmi që ndihet kështu kur i duket sikur vjen djali t'i tregojë arat babait, prandaj do të dëshiroja që secili të shqyrtojë zemrën e tij e të sigurohet që ka të njëjtin qëndrim të kërkuesit të së vërtetës, siç përshkruhet më sipër, sepse qëllimi i këtij shkrimi nuk është të tregojë se kush fiton apo humb me argumente, as kush është më i zgjuar e kush ka të drejtë, por sa të jetë e mundur të shohim më qartë për të kuptuar të vërtetën që në masën më të madhe nuk varet nga inteligjenca sa nga qëndrimi i zemrës.

Tri ngjarje sqaruese

Kam ndërmend të merrem këtu me disa pyetje që natyrshëm dolën para meje, ndërsa përpiquesha të kuptoja më mirë disa koncepte myslimane kur i ballafaqoja me Biblën, “Libri” siç quhet nga Kurani që e konsideron si fjalën e Zotit (Sura 3:84; 5:43-47). Myslimanët vërtet besojnë shumë gjëra për Zotin që janë të ngjashme me ato që besojnë të krishterët. Unë nuk do të paraqes këtu gjithë gamën e ngjashmërive apo ndryshimeve të kuptimit të tyre për Zotin, por do të shkëpus tri çështje që janë të lidhura në një mënyrë shumë domethënëse:

- 1) **festa** myslimane e Kurban Bajramit;
- 2) **lindja** e Jezuit (Isai) dhe kurbanit;
- 3) **kryqi** i Jezu Krishtit dhe kurbanit.

1. Festa e Kurban Bajramit

Aishja tregon se Muhameti ka thënë: ‘Në Ditën e Kurbanit njeriu nuk ka bërë asgjë më të pëlqyeshme për Zotin se derdhjen e gjakut, sepse me të vërtetë gjëja e gjallë e flijuar do të vijë në Ditën e Ringjalljes me brirët e tij, flokët, thundrat dhe pesha e veprës së sakrificës do të jetë e madhe, vërtet gjaku i tij arrin pranimin, pëlqimin e Zotit para se të bjerë në tokë, prandaj gëzohuni në të.’

(Mishkat, Libri 4, kapitulli 42, seksioni 2)

Një detaj i pavlerësuar i një historie të njohur

Myslimanët dhe të krishterët kanë ngjashmëri edhe në shumë përshkrime

të figurave historike, si për shembull: Abrahami (Ibrahimi). Të dy palët e tregojnë me shumë pasion historinë e birit që iu lind Abrahamit në një moshë të vjetër dhe pastaj iu kërkua nga Zoti që ta bënte kurban. Myslimanët e vlerësojnë aq lart Abrahamin dhe e kanë besimin e tij një shembull kaq të madh, saqë çdo vit e përkujtojnë këtë ngjarje në festën e Kurban Bajramit. Çdo vit ata duhet të zgjedhin qengjin më të mirë, pa asnjë difekt apo të metë, qengjin e përsosur. Duhet ta therin pastaj duke derdhur gjakun e tij në kujtim të historisë kur Zoti i siguroi dashin Abrahamit për ta therur në vend të djalit të vet, të cilin Ai i kishte kërkuar ta bënte kurban për t'i provuar besimin.

Një detaj i vogël i kësaj historie ngre një pyetje të rëndësishme për ta shqyrtuar seriozisht. Ndërsa po shkonin në vendin ku do bëhej kurban, i biri e pyet Abrahamin: “Baba, zjarrin edhe drutë i kemi, po ku është qengji për sakrificën (kurbanin)?” (Zanafilla 22:7). Duket që djali e dinte procedurën e ritualit të kurbanit. Ndoshta e kishte parë të

atin të bënte kurbane të tilla disa herë më parë. Kjo pyetje ngre një çështje të rëndësishme për diskutim: Cili është kuptimi i ritualit të kurbanit dhe kur u bë kurban i parë?

Origjina e çështjes së kurbanit

Pse bëheshin kurbanet apo cili është qëllimi i kurbanit?

Bibla, “Libri” që Kurani vetë e konsideron Fjalën e Zotit (Sure 6:154-157; 40:12), shkruar në histori dhjetra shekuj para Kuranit, ka informacion të dorës së parë për këtë (Sure 10:94), domethënë Abrahami vetë dhe Moisiu e të tjerë kanë lënë shkrime apo kujtimet e veta që përmbledhen në Bibël, siç i frymëzoi Zoti.

Që në fillim në Bibël, ne lexojmë se Zoti i tha Adamit: “Kur të hash nga kjo pemë (pema e njohjes së të mirës dhe të keqes), ti patjetër do të vdesësh” (Zanafilla 2:16,17).

Ngrënia nga pema nënkuptonte mosbindjen ndaj Perëndisë dhe pikërisht mosbindja ose rebelimi ndaj Perëndisë është ajo që përkufizohet si mëkat.

Për të kuptuar më mirë kontekstin e bërjes së kurbanit të parë, besoj se ia vlen të ndalemi për pak momente, duke imagjinuar situatën në kopshtin e Edenit në mbrëmjen e ditës kur Adami dhe Eva mëkatuan, duke ngrënë nga pema e ndaluar.

Jeta si bashkëmiqësi me Perëndinë

Perëndia i kishte bekuar njerëzit (Adami dhe Eva) me shumë forma të kënaqësive të jetës ku mund të zgjidhnin pafundësi aktiviteteesh krijuese me natyrën, me shoqërinë e njëri-tjetrit dhe me artin e fluturimeve të shpirtit njerëzor në praninë e Tij.

Në filladin e ditës (Zanafilla 3:8), kur vjen koha për të shijuar shoqëri dhe biseda pas një dite të mbushur me aktivitet, Perëndia

vjen si zakonisht të shoqërohet me krijesat e Tij njerëzore. Këtë radhë do të jetë hera e fundit, sepse Adami dhe Eva kanë vendosur ta prishin miqësinë me Të, që nënkuptohet nga mëkati i kryer tashmë nga ata, duke mos dëshiruar të bëjnë atë që donte Zoti Perëndi, por atë që dëshiruan vetë.

Kjo zgjedhje e njerëzve të parë, paraardhësve tanë, për të jetuar pa mbajtur këshillat dhe pa iu nënshtruar urdhrave të Perëndisë do të thotë prishje e marrëdhënies harmonike që kishin me Perëndinë bazuar në besimin te fjala e Tij. Adami dhe Eva as që duan t'i dalin në takim si zakonisht Perëndisë, por, ashtu siç do t'i fshiheshin njëri-tjetrit në një pyll të dendur, futen më kot për t'u fshehur në mes pemëve të kopshtit. Megjithëse ata e dinë se asgjë nuk mund t'i fshehë nga sytë e Zotit, mendojnë se Ai do ta kuptojë që ata s'duan ta takojnë më dhe do t'i lërë të qetë, ashtu si kur dikush që nuk do të takohet me ty, duket sikur nuk të vë re kur haseni në rrugë, duke shpresuar se ti nuk do të duash të takohesh me të

gjithashtu. Por Perëndia nuk i la të qetë, sepse i donte më shumë se ç'e donin ata.

Një pjesë të bisedës së asaj dite është e regjistruar në kapitullin e tretë të librit të parë të Biblës dhe pas bisedës: “Zoti Perëndi i bëri Adamit dhe gruas së tij tunika prej lëkure dhe i veshi” (Zanafilla 3:21). Duke qenë i bindur se lëkurët edhe në atë kohë nuk gjendeshin si gjethe të ndonjë peme të veçantë, unë besoj se Zoti theri një kafshë për të siguruar lëkurën e nevojshme për veshjen e Adamit dhe Evës.

Duhet të ketë qenë hera e parë që njerëzit panë gjak me sy dhe duhet të ketë qenë një mësim i paharrueshëm ai që Adami dhe Eva morën atë ditë. Adami e njihte mirë qengjin që u ther atë ditë, sepse ai vetë i kishte vënë emrin pak kohë më parë (Zanafilla 2:19). Ai qengj i parajsës ishte i përsosur dhe i bindur si manar. Zoti duhet t'i ketë kujtuar Adamit dhe Evës se edhe ata kishin qenë si ai qengj, pa asnjë të metë dhe të bindur si fëmijë të mirë, përpara se të vendosnin të rebeloheshin ndaj Perëndisë, duke ngrënë

frutin e pemës së ndaluar. Perëndia u kishte thënë se pasoja e mëkatit është vdekja dhe tani ishte koha për ta parë çdo të thotë kjo. Çfarë kanë menduar Adami dhe Eva kur panë gjakun të vërshojë nga koka e prerë e qengjit të përsosur kur nuk kishte më as blegërimë, as ndonjë lëvizje të kafshës së dashur?

Vdekja si ndarje

Nëse jeta shfaqet si një dinamikë lëvizjeje që ka kuptim kur të paktën dy gjëra ndërveprojnë me njëra-tjetrën, si gjaku që lëviz në venat e trupit, atëherë vdekja është mungesa e kësaj që ndodh nga një ndarje, shqepje, copëtim i diçkaje të bërë për të qenë si një e tërë. Një mësim i qartë për Adamin dhe Evën duhet të ketë qenë se njeriu u bë për të jetuar në praninë e Perëndisë, ashtu siç është bërë gjaku për të qëndruar në trup, dhe prishja e kësaj lidhjeje apo ndarja e këtyre dy gjërave, derdhja e gjakut nga trupi, çon

në vdekje. Këtë ndarje nga Perëndia e ka realizuar mosbindja e tyre në ngrënien e frutit të ndaluar; gjërat nuk janë më siç ishin. Frika dhe tmerri duhet t'i ketë pushtuar në këtë situatë prindërit tanë mëkatarë.

Mëkati si shkaku i vdekjes

Unë besoj se therja e qengjit nga Perëndia ka përfshirë një mësim edhe më të thellë se kaq. Unë e imagjinoj bisedën e Perëndisë të ketë vijuar pak a shumë kështu: “Adam, ky qengj nuk meriton të vdesë, sepse nuk është si ti që ke mëkatuar. Ti ke sjellë vdekjen mbi vete Adam dhe mbi gjithë racën njerëzore që do vijë nga fara jote. Tani që e sheh realitetin e vdekjes, ti dëshiron të kthehesh edhe një herë në gjendjen e pafajsisë si ky qengj i Parajsës, por nuk do shumë mend për të kuptuar që kjo është e pamundur, përndryshe jeta do të ishte një lojë.

Unë nuk kisha ndërmend të luaja kur

krijova jetë nga vetja ime, prandaj, me gjithë seriozitetin e mundshëm, të paralajmërova se jeta jote varet nga marrëdhënia me mua, bazuar në besimin tek unë dhe mosbesimi yt i shfaqur nga ngrënia e frutit të ndaluar prish këtë lidhje jetësore për ty, duke sjellë ndarjen nga Unë, d.m.th., vdekjen.

Mëkati ka pasoja të pashmangshme; mëkati nuk është si një fjalë goje që e merr era, por ndryshon jetën në vdekje. Unë ta kam thënë këtë që në fillim dhe ju do ta provoni vetë këtë vdekje që ka filluar në momentin e mëkatit, duke ju ndarë shpirtërisht nga unë dhe në pak kohë, duke e ndarë edhe jetën nga trupi juaj, ashtu siç u nda gjaku nga trupi i këtij qengji të therur”.

Kurbani si përkujtimore e dashurisë

“**T**ani ka ardhur koha t’ju them çfarë duhet bërë në këtë situatë, - vazhdoi Perëndia.
- Unë ju dua dhe tani po ju tregoj se çfarë do të bëj për ju. Meqë mëkati është shkaku

vdekjeprurës, Unë duhet të të pastroj ty nga barra e mëkatit, duke e marrë vetë atë barrë, duke bërë kurban për ty. Më vonë do ta kuptosh më mirë këtë, por tani kupto një gjë themelore: kurbanit paraqet dashurinë e ndërhyrësit zëvendësues.

Kurbani paraqet një ndërhyrje për të zgjidhur këtë situatë të shkaktuar nga mëkati dhe zgjidhja lidhet me zëvendësimin. Ja si bëhet kjo: shiko këtë qengj. Imagjino që ato gjethe fiku të mjera simbolizojnë përpjekjen tënde për të mbuluar apo zgjidhur problemin apo barrën e mëkatit tënd. Sigurisht që është e qartë se kjo përpjekje jotja me mbulimin e gjetheve nuk e zgjidh problemin, por ato gjethe janë një deklaratë e ndërgjegjësimit tënd për fajin që sjell mëkati.

Faji yt, pra, në ato gjethe është veshja jote e mëkatit. Ti je mëkatar dhe veshja jote e tregon këtë. Tani kjo veshje dhe ky faj do të vihet mbi qengjin e paraajsës. Kështu qengji, duke u veshur me mëkatin tënd, do të identifikohet me ty, do të konsiderohet

fajtori që duhet të marrë vdekjen, e cila është pasoja e pashmangshme e mëkatit. Meqë ai bëhet zëvendësuesi yt, derdhet gjaku i qengjit që nënkupton pagimin e mëkatit me jetë, kurse mbi ty do të vihet pafajsia e qengjit të parajsës, ashtu si lëkura e tij e bardhë që simbolizon veshjen e të pastrit dhe të drejtit.

Ti do mbulohesh me veshjen e përsosmërisë dhe do të konsiderohesh sikur të ishe i pafajshmi, duke marrë kështu një jetë të re dhe një identitet të ri. Premtimi është ky: në kohën e caktuar unë do të sjell qengjin tim të përsosur, që do të lindë nga fara e gruas, por deri atëherë bëjeni këtë ritual të kurbanit, që të kujtoni se si ndërhyj unë për zgjidhjen e mëkatit tuaj.” (*Zanafilla 3:15*)

Kurbani si shenjë e shpëtimit për të gjithë brezat

Ky koncept i kurbanit duket të ketë zënë vend mirë në jetën e njerëzve qysh nga

Adami. Ne shohim që fëmijët e Adamit dhe Evës bënë kurban (Zanafilla 4:3-4), pastaj edhe pas përmbytjes së madhe kur vetëm familja e Noes mbijetoi, shohim bërjen e kurbanit të vazhdojë si më parë (Zanafilla 8:20). Në këtë kontekst duhet kuptuar pse edhe Abrahami praktikonte kurbanin dhe i biri ishte i njohur me ritualin e kurbanit.

Kuptimi i kurbanit, pra, është i qartë, ashtu si shkruhet më vonë te Levitiku kapitulli 16: “Do të bëhet kurban për ty, për të të pastruar para Zotit. Ti do të jesh i pastruar nga të gjitha mëkatet e tua”. Gjaku i kurbanit është mënyra se si bëhet pastrimi nga mëkati, shlyerja e borxhit ndaj drejtësisë. “Sepse jeta qëndron në gjakun, prandaj ju kam urdhëruar ta vini këtë (flinë) mbi altar për të bërë shlyrjen për jetën tuaj, *sepse është gjaku që bën shlyrjen e fajit për jetën*” (Levitiku 17:11).

Ishte Zoti vetë që bëri kurbanin e parë, duke derdhur gjakun e një kafshe. Duke i dhënë Adamit lëkurën e kafshës për veshje, tregohet qartazi se si Perëndia siguron për

mbulimin e mëkatit të Adamit. Zoti është shpëtimtari; Zoti është i vetmi që ka mundësi të shpëtojë njeriun nga pasoja e pakthyeshme e mëkatit dhe e ka treguar që mënyra se si bëhet kjo është me derdhjen e gjakut që vetë Zoti e siguron, ashtu siç e siguroi dashin për Abrahamin.

Ky koncept i kurbanit si mbulim mbrojtës për të mënjanuar goditjen ndaj mëkatit përshkruhet qartë edhe kur Zoti i shpëtoi izraelitët në Egjipt. Te kapitulli 12 i Eksodit lexojmë se si siguroi Zoti për mbrojtjen e tyre: “...merrni një qengj... qengji të jetë pa të meta... thereni në të ngrysur... pastaj do të merrni gjakun dhe lyeni shtalkën e derës ku do ta hani... Unë do të kaloj dhe do të godas,... unë jam Zoti. Gjaku do të jetë një shenjë, kur të shoh gjakun do të kaloj tutje dhe nuk do të ketë plagë mbi ju për t’ju zhdukur kur të godas... Ajo do të jetë për ju një ditë për t’u mbajtur mend... kur bijtë tuaj t’ju pyesin çfarë kuptimi ka ky rit për ju, përgjigjiuni: “Kjo është flija e pashkës së Zotit që goditi

Egjiptin... dhe i fali shtëpitë tona... veprohet kështu, për shkak të asaj që bëri Zoti për mua...”

Mëkati si sëmundje

Pse Zoti nuk fal thjesht pa kërkuar gjë? Pse duhet derdhur gjaku patjetër?

Duhet të mbajmë parasysh se, megjithëse Zoti është i ofenduari nga rebelimi i njeriut dhe vetëm Atij i kemi borxhin e fyerjes apo të mëkatit, prandaj vetëm Ai mund të na falë, mëkati është më shumë si një sëmundje që ka nevojë për ilaç, jo vetëm për një fjalë faljeje. Unë nga dashuria mund t'i them “të kam falur” djalit tim që, duke thyer urdhrin tim, pi lëngun helmues, por ai ka nevojë edhe për një vepër konkrete shëruese, për ta asgjësuar shkaku vdekjeprurës.

Këtu kemi rastin të bëjmë një dallim të rëndësishëm midis fjalës “mëkat” dhe shumësit të kësaj fjalë “mëkate”. Zakonisht

njerëzit kur përmendin fjalën “mëkat” thjesht mendojnë një nga mëkatet e shumta, si: gënjeshtria, vjedhja, vrasja, por koncepti i mëkatit si një dukuri, duke iu referuar me formën njëjës “MËKATI”, duhet kuptuar më shumë si një sëmundje dhe “mëkatet” si pasojat apo simptomat e kësaj sëmundjeje. Pra, gënjeshtria, vjedhja, vrasja, janë më shumë si format e ndryshme që merr “sëmundja mëkat” në ecurinë e jetës së njerëzve, janë më shumë si simptomat e një sëmundjeje, p.sh. temperaturë, kollë, të vjella, ndërsa shkaku është një ç'rregullim i sjellë nga një mikrob apo sëmundje e thellë si kanceri. Kjo shpjegon pse, megjithëse të gjithë njerëzit e kanë sëmundjen mëkat, jo të gjithë kanë të njëjtat simptoma; por ama të gjithë vdesin në fund.

Mëkati si krim

Mëkati gjithashtu është më shumë se një fyerje dhe më e ngjashme me një krim

të rëndë. Nuk duhet të harrojmë që mëkati i Adamit dhe Evës ishte mosbindja ndaj Perëndisë, ishte një zgjedhje vullnetare për të shkuar kundër Perëndisë, jo thjesht një mikrob që u hyri pa dashjen e tyre. Mëkati është një sëmundje shpirtërore dhe ndikon, por nuk e asgjëson vullnetin e njeriut, prandaj nuk mund të anashkalohet përgjegjësia personale për mëkatin. Nëse do të vazhdonim me kuptimin e mëkatit si krim dhe Zotit si administratori i drejtësisë apo përgjegjësi sovran për të zbatuar drejtësinë në botën e tij, do kuptonim më mirë seriozitetin e çështjes. “Paga për mëkat është vdekja” (Rom. 6:23) - kështu thotë ligji i drejtësisë së tij.

Supozo se je në një sallë gjyqi ku gjykatësi, pasi ka vërtetuar vrasjen e babait, nënës dhe gjithë familjes tënd nga kriminelin që tashmë është ngritur në këmbë për të marrë dënimin, thotë: “Meqenëse kjo ishte vrasja e parë që ka bërë ky njeri ndër kohë që ishte i dehur dhe ne të gjithë e shohim se ai e ka kuptuar fajin e vet dhe ka kërkuar

falje unë e deklaroj të falur”. Si do të ndiheshe ti? Nëse Zoti do të ishte një gjykatës i tillë kapriçoz që mund ta lërë mëkatarin të lirë nga dënimi që meriton, ne nuk mund të kishim shpresë për drejtësi ndonjëherë dhe madje vetë kuptimi i fjalës drejtësi do të asgjësohej.

Zoti i ngjan më shumë një tjetërlloj gjykatësi. Unë kam dëgjuar për një histori të vërtetë, rreth një gjykatësi që vërtetoi fajin e një vajze të re në një kundravajtje automobilistike dhe e dënoi me gjobë në përputhje me ligjin. Ajo që i befasoj të gjithë, ishte se, pas vendimit, gjykatësi hoqi rrobën e tij zyrtare dhe iu afrua vajzës duke i zgjatur shumë e mjaftueshme të parave për gjobën. Ajo ishte e bija dhe, megjithëse gjykatësi duhej ta dënonte siç e meritonte faji i saj, në të njëjtën kohë ai siguroi për lirinë e vajzës së tij të dashur. Një krim që solli në botë kaq dhimbje dhe lot, meriton drejtësinë që Zoti premtoi, duke e dënuar me vdekjen, prandaj asnjë lloj falje që është predikuar ndonjëherë nuk e ruan dot ekuilibrin e drejtësisë dhe

dashurisë, si falja e kushtëzuar nga kurbanit që vetë Zoti siguron, ashtu si babai gjykatës.

Të gjithë jemi mëkatarë

Vetëm sa për ilustrim të kësaj pike, imagjino një kolonë njerëzish njëri pas tjetrit, ku i pari është Adami, e dyta Eva, pastaj me radhë të gjithë njerëzit që kanë lindur nga Adami në gjithë historinë, pa asnjë përjashtim, duke përfshirë edhe mua edhe ty e të gjithë njerëzit që jetojnë sot. Bibla thotë: “...me anë të një njeriu (Adamit) mëkati (sëmundja kriminale) hyri në botë e me anë të mëkatit, vdekja, dhe kështu vdekja kaloi në të gjithë njerëzit, sepse të gjithë njerëzit mëkatuan” (Rom. 5:12).

Ne të gjithë vdesim, sepse kemi sëmundjen mëkat dhe kush ka sëmundjen mëkat shpalos edhe simptomat e saj, duke mëkatuar, dikush me një gënjeshtër e dikush me më shumë. Anasjelltas mund të themi se kush ka mëkatuar duke shpalosur simptomat

e mëkatit me një gënjeshtër apo të tjera simptoma vërteton se ka sëmundjen mëkat. Të gjithë, pra, kemi mëkat që meriton vdekjen, prandaj po presim në radhë ekzekutimin një nga një. Duke kujtuar natyrën e mëkatit si indiferencë dhe rebelim kundër Perëndisë e kuptojmë mëkatën si një krim, prandaj askush nuk mund të dalë nga rreshti, sepse numri i krimeve është ekzaktësisht i barabartë me numrin e njerëzve dhe një krim (mëkati) lahet me një jetë.

Asnjë krim nuk mund të lihet pa u ndëshkuar. Pra, asnjë njeri nuk mund të lihet pa dënuar, përndryshe drejtësia nuk zbatohet.

Jashtë rreshtit mëkatar është vetëm i përsosuri: qengji i përsosur që nuk ka bërë krimin, prandaj nuk e meriton dënimin. Sipas këtij skenari, si mund të shpëtohesh ti? Si mund të shpëtohet qoftë edhe një njeri pa u anulluar drejtësia?

Paradoksi i drejtësisë dhe dashurisë

Ne shpëtohem vetëm nëse theret i përsosuri në vendin tonë, sepse vetëm i përsosuri nuk meriton vdekjen (Ligji i Përtërirë 15:21)! Ky paradoks që trondit çdo mendje njerëzore, merr kuptim vetëm kur kupton që Zoti i gjithësisë dëshiron të ndërhyjë, të shpëtojë njeriun nga dënimi i pashmangshëm i mëkatit. Po të mos ndërhyjë Zoti, njeriu thjesht merr atë që i takon: dënimin me vdekje të përjetshme. Vetëm në qoftë se krimi që kërkon një jetë njeriu shpaguhet me jetën e qengjit dhe ti merr vendin e qengjit jashtë rreshtit, ke shpresë për jetë të përjetshme.

Qengji, pra, bëhet kurban për njeriun. Njeriu ka bërë mëkatin që meriton vdekjen, por është qengji që merr vdekjen apo mëkatin mbi vete, duke i dhënë njeriut pastërtinë e tij, me një qëndrim si ai i nënës që i thotë birit: “T’u bëfsha kurban!” ose “Të marrsha të keqen!”

Nga historia e Abrahamit, del qartë që ishte Zoti ai që siguroi qengjin për ta zëvendësuar me birin e Abrahamit. Kurhani në këtë rast nuk u bë për mëkatin e Abrahamit apo të birit të tij, por dukshëm është simbolika e Zotit që siguron qengjin e përsosur - "...kurban të rëndësishëm" siç e quan Kurani (Sure 37:107). Në mbyllje të kësaj pike, dua që të mbajmë në mendje përgjigjen ndaj pyetjeve që morën shkas nga reagimi i birit të Abrahamit: Cili është qëllimi i kurbanit? Pse një qengj i përsosur?

2. Lindja e Jezuit dhe Kurbani

“Midis njerëzve ... bota e re u shfaq me tipare të papara ndonjëherë – në varfërinë e kasolles poetike – një bir i të parës Virgjëreshë dhe Nënë – fryt i pafund i përqafimit të mistershëm. ... Vetë, zemra qiellore u shpalos si një brerore lulëzimi dashurie të plotfuqishme... kthyer kah lartësia e ftyrës së Atit dhe mbështetur në butësinë e gjirit të dashur dhe dëshirues të Nënës...”

(Novalis, Hymne Natës, Seksioni 5)

Pika e dytë që dua të theksoj ka të bëjë me një çështje tjetër që myslimanët dhe të krishterët e kanë të përbashkët: lindja e Jezuit. Në Kuran është e shkruar se Jezui u

lind pa baba dhe kjo është një shenjë për ata që besojnë (Sure Merjeme 19:20,21). Atëherë, që të jesh mysliman do të thotë të besosh në lindjen e mrekullueshme të Jezu Krishtit nga virgjëresha. Kjo, thotë Kurani, është një shenjë për të dalluar nëse je besimtar.

S’kam takuar akoma një mysliman të vërtetë që të mohojë këtë, por ama, s’kam takuar as ndonjë mysliman që i përgjigjet mjaftueshëm pyetjes sime: *“Cilin qëllim do Zoti të përmbushë, me lindjen e Jezuit pa baba, nga një virgjëreshë?”*

Shpjegime të pamjaftueshme të Krishtlindjes

Disa thonë që ishte thjesht për të treguar që Zoti është i fuqishëm, por unë mendoj se ata e rrëzojnë vetë këtë përgjigje kur thonë se Zoti e bëri si me Adamin, që ishte krijuar pa nënë edhe pa baba. Pra, Zoti, s’kishte ndonjë gjë të re për të na treguar,

nëse Jezui është një krijesë; ne e dinim që Zoti krijon nga asgjëja. Sigurisht që mrekullia e lindjes së Jezuit pa baba nuk mund të ishte as për të bindur njerëzit që të besojnë se Zoti mund ta bëjë këtë, sepse askush përveç Marisë (Merjemes) nuk ishte dëshmitar dhe të gjithë duhet ta pranojnë me besim lindjen pa baba të Jezuit. Prandaj pyetja mbetet: *Pse Jezui, ndryshe nga gjithë njerëzit e botës, u lind në këtë mënyrë?*

Domethënia e lindjes nga virgjëresha

Të jesh profet, nuk ke nevojë të lindesh pa baba. Kurani e konsideron Jezuin një nga profetët më të shquar që ringjalli njerëz nga të vdekurit (Sure 3:49) dhe bëri mrekullitë më të mëdha, thekson që ishte pa mëkat (Sure 19:17,19), flet për të si Fjala e Zotit (Sure 3:45), madje thotë se Jezui është me trup sot në qiell (Sure 4:158) dhe do të vijë për ditën e gjykimit (Sure 43:61). Por, për sa i përket lindjes, thjesht e përshkruan,

pa dhënë një përgjigje për qëllimin e Zotit në lindjen e tij pa baba.

A ka mundësi që Jezui të jetë lindur pa baba që të ishte pa njollën e mëkatit, (tendenca me të cilën lind çdo njeri që prej Adamit), që të ishte i vetmi njeri plotësisht i panjollë dhe i drejtë, i vetmi plotësisht i përsosur në gjithë historinë njerëzore?

A ka mundësi që Jezui të jetë Qengji i Zotit, i simbolizuar në shekuj si qengji i kurbanit, i premtuar që në kopshtin e Edenit, që u shfaq në kohën e caktuar? Profeti i njohur si Gjon Pagëzori, kur e pa Jezuin në fillimin e misionit të tij, deklaroi me gëzim: “Ja qengji i Zotit që lan mëkatën e gjithë botës” (*Ungjilli Gjoni 1:29*). Në përmbushjen e misionit të Jezuit me vdekjen e tij në Kryq dhe ringjalljen, u vërtetua deklarata e Gjon Pagëzorit, siç thuhet më vonë: “...pashka jonë që është Krishti, u flijua për ne” (*Letra 1 Korintasve 5:7*).

Tani vijmë në pikën kritike, vendin ku kryqëzohen e ndahen gjithë fetë e botës: kryqi i Jezu Krishtit dhe domethënia e tij.

3. Kryqi dhe Kurbani

Kryqi nuk është një simbol, është qendra e universit, bërthama e historisë, ngjarja më kuptimplote që ka ndodhur ndonjëherë.... Në kryqin e lavdisë, vdekja e tij ishte jetë për mua, një sakrificë e misterit më të shenjtë të dashurisë. Vdekja u gëzua që e shtiu në dorë, por së shpejti ai do të ishte i lirë, sepse dashuria gjithmonë ka fitoren....

*Majkëll Kard "Kryqi i Lavdisë"
në "Emanuel: Reflektime mbi Jetën e Krishtit"*

Pika e tretë ka të bëjë me një çështje ku, myslimanët dhe të krishterët ndahen plotësisht. Çuditërisht kjo ka të bëjë me çështjen më të qartë, që mund të analizohet

pa hyrë në debate teologjike: vdekja e Jezuit në kryq.

Historia si monument asnjëanësie

Vdekja e Jezuit në kryq është një ngjarje historike. Ajo ose ka ndodhur (siç thonë të krishterët) ose nuk ka ndodhur (siç thonë myslimanët). Ashtu si çdo ngjarje historike, edhe kjo duhet shqyrtuar në bazë të dëshmive historike, dëshmitarëve okularë dhe jo në bazë të ideve të paracaktuara apo paragjytimeve. Zakonisht, mosbesimi lidhur me besueshmërinë historike të Krishterimit, që bazohet në vdekjen e Jezuit në kryq dhe ringjalljen e tij, është rrjedhojë e paragjytimeve, se mrekullitë nuk mund të ndodhin duke nënkuptuar mosbesim në të mbinatyrshmen. Por myslimanët, në fakt, besojnë në të mbinatyrshmen, ata madje besojnë që Jezui është i gjallë me trup sot në qiell, siç thotë edhe Bibla.

Turpi i kryqit është i rëndë

Një arsye e fortë për myslimanët që ta mohojnë vdekjen e Jezuit nuk ka të bëjë me faktet historike (ata nuk sjellin argumente historike për këtë pikë), por me turpin që përfaqëson kryqi. Sipas këtij këndvështrimi, Zoti s'mund të lejonte që Jezui, profeti i madh, të ç'nderohej dhe të mallkohej me një vdekje të denjë vetëm për kriminelët në kryq.

Është për t'u theksuar këtu se, edhe pasuesit e Jezuit, ata që për disa vjet e kishin ndjekur kudo dhe kishin parë mrekullitë e tij dhe ishin të bindur që ishte Krishti, kur vdiq Jezui në kryq mendonin në të njëjtën mënyrë si myslimanët, sepse e dinin që në Bibël shkruhet: “Në rast se dikush ka kryer një krim që meriton vdekjen dhe ka pësuar vdekjen, dhe ti e ke varur në një dru, kufoma e tij nuk do të rrijë tërë natën mbi pemën, por do ta varrosësh po atë ditë, *sepse ai që rri varur është i mallkuar nga Perëndia* dhe ti nuk do ta ndotësh tokën që Zoti, Perëndia yt të

jep si trashëgimi” (Ligji i Përtërirë 21: 22-23).

Megjithëse Jezui ua kishte shpjeguar me hollësi para se të ndodhte pse dhe si ai duhet të vdiste si kurban për mëkatën (Gjoni 12), prapëseprapë pasuesit e tij nuk mund ta besonin që Jezui, autori i ringjalljes së Lazarit (Gjoni 11) mund të vdiste.

Unë njësohem plotësisht me myslimanët në këtë ndjenjë të thellë nderimi për Jezuin e pastër pa asnjë njollë, të dërguarin e Zotit. Krishti nuk e meritonte të vdiste. Krishti nuk mëkatoi. Jezui ishte i vetmi pa mëkat, pa asnjë faj, pa asnjë të metë. Jezui ishte i përsosur, po, Jezui nuk e meritonte të vdiste, sidoqoftë, pikërisht këtu duket qartë ngjashmëria me qengjin e kurbanit. Qengji ishte pa asnjë të metë, pa njollë, i përsosur. Qengji nuk e meritonte të vdiste. Njeriu, mëkatari po, e megjithatë ishte qengji i përsosur që u trajtua si keqbërësi.

Duke patur parasysh domethënien e kurbanit, siç e kemi shpjeguar më lart, është e kuptueshme të pyesësh: A ka mundësi që

Jezui vdiq vdekjen time dhe vdekjen tënde në kryqin e turpit, që unë dhe ti të jetojmë në faljen dhe dashurinë e Zotit?

A ka mundësi që qëllimi i Zotit për Jezuin e ardhur nga lart, i lindur jo nga fara e burrit, të jetë sigurimi i qengjit për kurban për mua dhe për ty, për mëkatarët?

Kuptimi që nuk erdhi nga arsyetimi

Këtë përfundim për kurbanin e kryqit dhe kuptimin e tij, pasuesit e Jezuit nuk e nxorën nga debatet teologjike, por nga goja e vetë Jezuit, pasi e panë të gjallë pas vdekjes dhe varrimit, kur prekën me dorë vendin e plagëve të tij pas ringjalljes, kur, të mahnitur hanin peshk rreth zjarrit në breg të liqenit me atë që e kishin qarë të vdekur pak ditë më parë, kur, para se të ngjitej në qiell mu para syve të tyre, u tha: “Këto janë fjalët që unë ju thoja kur isha ende me ju, se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në ligjin e Moisiut, në profetët

dhe psalmet”. Atëherë ua hapi mendjet e tronditura nga vdekja në kryq që të kuptonin Shkrimet, duke u thënë: “Kështu është shkruar dhe kështu ishte e nevojshme që Krishti të vuante dhe të ringjallej së vdekuri ditën e tretë dhe që në emër të tij të predikohet pendimi dhe falja e mëkateve ndër të gjithë popujt... ju jeni dëshmitarët e këtyre gjërave”(Luka 24:44-48).

Kuptimi që i qëndron edhe arsyetimit

Nevoja për kurbanin bëhet e qartë, sepse Ne thekson nga njëra anë seriozitetin e mëkatit dhe pashmangësinë e dënimit për çdo mëkatar, por nga ana tjetër kurbanin nxjerr në pah një lloj dashurie vetëfljuese të paimagjinueshme. Ne nuk mund të imagjinojmë dot që kjo të ketë ndodhur. Shumë njerëz, edhe pasi e kuptojnë, e kanë të vështirë ta pranojnë këtë të vërtetë. Nuk mund ta imagjinojmë një dashuri të tillë për

ne që ta bënte Jezuin e përsosur të varej në kryq si kurban për mua dhe ty. Në vend të gëzimit, çuditërisht mendjen mund ta pushtojnë pyetje të tjera, si: “A nuk është padrejtësi që Zoti të dënojë një person tjetër në vendin tim?”

Çështja e palës së tretë

Gabimi i zakonshëm bëhet kur kuptohet sikur kemi tre palë të përfshira në procesin e kurbanit: (1) mëkatari, (2) Perëndia, (3) Jezui. Në të vërtetë, kemi të bëjmë vetëm me dy palë: (1) mëkatari dhe (2) Perëndia. Historia e Abrahamit (kur merr me mend agoninë e atit që sakrifikon birin për hatër të dikujt tjetër) mund të shërbejë edhe si simbolikë e dashurisë së Zotit. Kryqëzimi i Jezuit ndodhi: “Sepse Zoti aq shumë e deshi botën, sa dha Birin e tij, që kushdo që beson në Atë të mos humbë, por të ketë jetën e përjetshme” (Ungjilli i Gjonit 3:16).

Ashtu si Abrahami me siguri ka qenë gati të vdiste vetë para se të linte të birin të vdiste, edhe Ati Perëndi e siguroi nga vetja gjakun që duhej të derdhej për ne. Ai sakrifikoi nga vetja e tij kur lejoi Jezui Krishtin të vdiste në kryq për njerëzit. Ai nuk ia hodhi dënimin dikujt tjetër, një pale të tretë, por pagoi nga vetja, sepse Bibla e thotë qartë që Ati dhe Biri janë NJË (Gjoni 10:30), Ati është në Birin dhe Biri është në Atin (Gjoni 10:38), “Ati qëndron në mua, është Ai që i bën veprat,” - thotë Jezui (Gjoni 14:10). Pra, Ati dhe Biri (Jezui) janë NJË PALË e vetme në këtë histori, edhe pse ata janë dy persona të veçantë.

Në të njëjtën kohë duhet të mbajmë parasysh se kemi Jezuin që thotë: “Prandaj Ati më do, sepse unë e lë jetën time... askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja...” (Gjoni 10:17-18). Duke bërë vullnetin e Atit, Jezui Krishti bën edhe vullnetin e tij, Ai e dha jetën në kryq vullnetarisht.

Kuptimi që kërkon besim personal

Duke larguar keqkuptimin e kurbanit si padrejtësi ndaj Jezuit, sikur ai të ishte një viktimë kur në realitet ai është një hero, le t'i kthehemi faktit që ai vdiq për ty!

Vështirë në fakt, të vdesë dikush për një njeri të drejtë, por mbase ndonjë edhe do të vdiste për një njeri të mirë. Ama, “Zoti e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që kur ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne” (Romakët 5:7,8). Nuk mund të presim një dashuri të tillë nga dikush që nuk e njohim e nuk e nderonim, por Zoti është mahnitës. “Zoti është dashuri”, thotë Bibla.

Askush nuk mund ta kuptojë një dashuri të tillë, por nga ana tjetër nuk pritet që të kuptojmë gjithçka. Ajo që duhet kuptuar është se megjithëse Zoti e ka bërë kurbanin për ne, Ai nuk detyron askënd ta pranojë këtë pa vullnetin e vet. Është e shkruar: “...Kur dikush ... sjell një sakrificë... ta çojë... me vullnetin e tij përpara Zotit. Do

të vërë pastaj dorën e tij mbi kokën e flisë, që do të pranohet NË VEND TË TIJ, për të shlyer dënimin NË VEND TË TIJ” (Levitiku 1:2,3,4).

Pashmangshmëria e përgjigjes

Nëse do të ishe para Zotit tani dhe ai do të të pyeste se çdo të bësh me kurbanin e Tij për ty, çfarë do t’i thoje? Mbaje parasysh se, në qoftë se Zoti ka bërë një kurban për ty, që është e vetmja shpresë shpëtimi (Jezui - qengji), atëherë ka vetëm dy pozicione që përcaktohen nga një përgjigje e jotja për pyetjen: “Do ta pranosh kurbanin që Perëndia bëri për ty?” Është e pashmangshme për ty të japësh një përgjigje, sepse, pas përballjes me këtë histori të Jezuit, çfarëdo që të vendosësh është një lloj përgjigjeje. Nëse thua po, do të thotë se ti pranon dhe beson në Jezuin si qengjin e Zotit që merr dënimin për mëkatin tënd. Çdo përgjigje tjetër, të lë ty në pozitën e atij që

do të vuajë vetë dënimin e tmerrshëm për mëkatin.

Qengji është zëvendësuesi që mund të dhurojë përsosmërinë e tij, pastërtinë e tij që ka si rezultat rivendosjen e marrëdhënies shpirtërore me Perëndinë e shenjtë, kurse çdo njeri mundet vetëm të zëvendësohet me qengjin, për të mos marrë dënimin që meriton për mëkatin, pra, vdekjen e përjetshme.

Në Bibël thuhet: “Në fakt, NJË është Zoti dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Zotit dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri, i cili e dha veten si çmim për të gjithë... në kohën e caktuar” (1 Timoteut 2:5,6). “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve me anë të të cilit ata shpëtohen” (Veprat 4:12).

Pasthënie

Unë u përpoqa të tregoj si merr përgjigje pyetja për kuptimin e kurbanit në lidhje me veprën e Jezu Krishtit, e cila është e vetmja përgjigje e plotë që kam gjetur. Koncepti i kurbanit, lindja nga virgjëresha dhe vdekja e Jezuit në kryq kanë një domethënie të rëndësishme dhe nuk janë rastësi.

Po kështu edhe ringjallja e Jezuit, ekzistenca e tij me trup sot në qiell, nuk është thjesht një histori për t'u mahnitur si me një përrallë, por ka një qëllim: atë të dhënies së një cilësie jete të re sot të gjithë atyre që e besojnë. Jezui i ringjallur thotë: “Unë qëndroj para derës dhe trokas, unë do të hyj tek ai që

e dëgjon zërin tim dhe e hap derën” (Zbulesa 3:20). “Atyre që e pranuan dhe i besuan, u dha të drejtën të bëhen fëmijë të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij” (Gjoni 1:12).

E gjitha kjo vjen nga dora e mëshirshme e Zotit gjithëdashës. Nuk bëhesh fëmijë i Zotit thjesht duke u lindur në këtë botë, pra, as nga gjaku, as nga vullneti i mishit, as nga vullneti i burrit, por lindur nga Zoti “ME BESIM” (shih Ungjillin e Gjoni 1:12,13 dhe 3:1-8). Bibla thotë: “Jeni shpenguar nga mënyra e kotë e trashëguar nga etërit jo me anë gjërash që prishen si argjendi ose ari, por me gjakun e çmuar të Krishtit si të qengjit të patëmetë dhe të panjollë, të paranjohur përpara krijimit të botës për t’u shfaqur kohët e fundit për ju” (Letra e Parë e Pjetrit 1:18-20).

Për ndihmë të mëtejshme

Katër Ligjet Shpirtërore

Një nga shpjegimet më të qarta dhe përmbledhjet më koncize të mesazhit të Biblës që unë kam gjetur, një nga prezantimet më të thjeshta për të ndihmuar dikë të kuptojë domethënien e veprës së Jezu Krishtit është broshura “Si ta njohim Perëndinë personalisht”. Unë dua që ju ta keni këtë përmbledhje të famshme të gjërave kryesore që një njeri ka nevojë të dijë për të filluar një marrëdhënie me Perëndinë, përmes Jezu Krishtit të gjallë.

*Ashtu siç ekzistojnë ligje fizike
që rregullojnë funksionimin fizik të gjithësisë,
ashtu ekzistojnë edhe ligje shpirtërore që
rregullojnë marrëdhënien tënde me Perëndinë.*

1

PERËNDIA TË DO DHE TË OFRON NJË PLAN TË MREKULLUESHËM PËR JETËN TËNDE.

*(Vargjet në këtë prezantim duhen
lexuar në kontekst me Biblën.)*

Dashuria e Perëndisë

“Po, Perëndia aq shumë e deshi botën, saqë
e dha Birin e tij të vetëm, që të mos humbasë
kushdo që beson në të, por të ketë jetën e
përjetshme” (Gjoni 3:16).



Plani i Perëndisë

(Jezui tha:) “Por unë kam ardhur që të kenë
jetë e ta kenë me bollëk” (që ajo të jetë e
begatë dhe kuptimplote) (Gjoni 10:10).

*Pse shumica e njerëzve nuk po e jetojnë këtë
jetë me bollëk? Sepse...*



**NJERIU ËSHTË MËKATAR
DHE I NDARË NGA PERËNDIA.
PRANDAJ AI NUK MUND
TË NJOHË DHE TË PËRJETOJË
DASHURINË DHE PLANIN
QË PERËNDIA KA PËR TË.**

Njeriu është mëkatar

“Të gjithë u bënë fajtorë dhe humbën madhësitinë që u dha Perëndia” (*Romakëve 3:23*).

Njeriu u krijua që të ketë shoqëri me Perëndinë, por për shkak të egoizmit të tij ai zgjodhi të ndiqte rrugën e vet të pavarur dhe shoqëria me Perëndinë u ndërpre. Këtë mënyrë të jetës pa Perëndinë që tregon indiferencë dhe rebelim kundër Tij, Bibla e quan mëkat.

Njeriu është i ndarë nga Perëndia

“Sepse paga e mëkatit është vdekja” (*ndarje shpirtërore nga Perëndia*) (*Romakëve 6:23*).



Ky diagram tregon se Perëndia është i shenjtë ndërsa njeriu mëkatar. Një humnerë shumë e gjerë dhe e thellë i ndan ata të dy. Shigjetat ilustrojnë njeriun që vazhdimisht mundohet të arrijë Perëndinë dhe jetën me bollëk me përpjekjet e veta, përmes veprave të mira, fesë a filozofisë.

Ligji i tretë shpjegon urën e vetme që bashkon njeriun me Perëndinë...

3

**JEZU KRISHTI ËSHTË E
VETMJA ZGJIDHJE E PERËNDISË
PËR MËKATET E NJERIUT.
PËRMES TIJ MUND TË
NJOHËSH DHE TË PËRJETOSH
DASHURINË QË KA PERËNDIA
PËR TY DHE PLANIN QË AI KA
PËR JETËN TËNDE.**

Ai vdiq që të mos vdisnim ne


“Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne” (*Romakëve 5:8*).

Ai u ngjall nga të vdekurit

“Mesia [*dmth. Krishti*] vdiq për mëkatet tona, në përputhje me profecitë e Shkrimit të shenjtë, dhe u varros. Ditën e tretë, ai u ringjall nga të vdekurit, siç parathuhej në Shkrimin e shenjtë, dhe iu shfaq Pjetrit dhe pastaj tërë rrethit të apostujve. Më vonë e panë më shumë se pesëqind dishepuj; disa kanë vdekur. por shumica janë ende gjallë” (1 *Korintasve 15:3-6*).

Ai është rruga e vetme për te Perëndia

“Jezui u tha: ‘Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati veçse nëpërmjet meje’” (Gjoni 14:6)



Ky diagram ilustron urën e vetme që ndërtoi Perëndia mes Atij dhe njeriut duke dërguar Birin e Tij të vetëm, Jezu Krishtin, që të vdesë në kryq për ne për të paguar dënimin për mëkatet tona.

Nuk mjafton vetëm t'i dish këto tri ligje shpirtërore...

4

**NE DUHET PERSONALISHT
TA PRANOJMË JEZU KRISHTIN
SI SHPËTIMTAR DHE ZOT E
ATËHERË MUND TË NJOHIM
DHE TË PËRJETOJMË DASHURINË
QË PERËNDIA KA PËR NE
DHE PLANIN QË AI KA
PËR JETËN TONË.**

Duhet ta pranojmë Jezu Krishtin

“Megjithatë, disa e pranuan dhe besuan në të. Ai u dha atyre të drejtën të bëheshin fëmijë të Perëndisë” (*Gjoni 1:12*).

Jezuin e pranojmë përmes besimit

“Në të vërtetë, vetëm me mëshirë jeni të shpëtuar. Vetvetiu nuk mund të bëni asgjë veçse ta pranoni me besim atë që Perëndia bëri për ju. Shpëtimin tuaj nuk e meritoni, por ai është dhuratë e Perëndisë. Askush nuk mund të mburret para Perëndisë për atë që ka arritur...” (*Efesianëve 2:8-9*).

Kur pranojmë Jezuin, fillojmë një jetë të re.
(*Lexo Gjonin 3:1-8*)

Jezu Krishtin e pranojmë me ftesë personale

(Jezui thotë) “Unë qëndroj para derës dhe trokas: kush e dëgjon zërin tim dhe e hap derën, do të hyj tek ai” (Zbulesa 3:20).

Të pranojmë Jezuin do të thotë që nga rruga e mëkatit të kthehemi (*pendohemi*) tek Perëndia, ta ftojmë atë në jetën tonë që të na i falë mëkatet dhe që të na bëjë ashtu siç dëshiron Ai të jemi. Nuk mjafton që vetëm ta pranojmë intelektualisht që Jezui është Biri i Perëndisë dhe se Ai vdiq në kryq për ne; nuk mjafton as përjetimi emocional. Por duhet ta pranojmë Atë përmes besimit, si vepër të vullnetit personal. Këto dy rrathe parapasin dy jetë të ndryshme:

JETA E DREJTUAR NGA VETJA

V - Vetja në fron

† - Jezui jashtë
jetës

- - Interesat udhëhiqen nga vetja dhe shpesh çojnë në çorientim dhe dëshpërim.



JETA E DREJTUAR NGA JEZUI

V - Jezui brenda jetës
i ulur në fron

† - Vetja nën drejtimin
e Jezuit

- - Interesat udhëhiqen nga Jezui, kjo sjell kënaqësi dhe harmoni sipas planit të Perëndisë.



Cili rreth e përfaqëson jetën tënde?

Cili rreth do të kishe dëshirë të përfaqësonte jetën tënde?

Jezuin mund ta pranosh si vijon:

**Që tani mund ta pranosh Jezuin me besim
përmes lutjes**

(Lutja është bisedë me Perëndinë)

Perëndia ta njeh zemrën dhe më shumë se fjalët dëgjon atë që të thotë zemra. Besimin tënd mund ta shprehësh me një lutje si kjo:

*“Zoti Jezu, kam nevojë për Ty.
Faleminderit që ke dhënë jetën për mua
në kryq. Unë e hap zemrën time dhe të
pranoj si Shpëtimtarin dhe Zotin tim.
Faleminderit që m’i fale mëkatet dhe që
më dhe jetën e përjetshme. Ulu në
fronin e jetës sime dhe udhëhiqe atë.
Më ndihmo që të bëhem ashtu siç
dëshiron Ti të jem.”*

A shpreh kjo lutje dëshirën e zemrës tënde?
Nëse po, në këtë çast mund të lutesh kështu
dhe ashtu siç ka premtuar, Jezui do të hyjë në
jetën tënde.

Si mund ta dish që Jezui është në jetën tënde tani?

A e pranove Jezuin në jetën tënde? Sipas premtimit të dhënë në librin e Zbulesës 3:20, ku është Ai tani në lidhje me ty? Jezui ka thënë se do të hyjë në jetën tënde. A do të të kishte gënjyer Ai? Si mund ta dish me siguri se Perëndia i është përgjigjur lutjes tënde? *(Përmes besimit në Perëndinë dhe Fjalën e Tij.)*

Bibla u premtonte jetën e përjetshme të gjithë atyre që pranojnë Jezuin

“Kjo dëshmi thotë: Perëndia na dha jetën e përjetshme dhe këtë jetë e marrim me anë të Birit të Tij. Kush e ka Birin e Perëndisë, ka edhe jetën. Kush nuk e ka Birin, nuk e ka as jetën. Po ju shkruaj që ta dini se jetën e përjetshme e keni sepse besoni në Birin e Perëndisë” *(1 Gjoni 5:11-13).*

Falënderoje shpesh Perëndinë që Jezui është në jetën tënde dhe që Ai kurrë nuk do të largohet prej teje *(Hebrenjve 13:5).* Sipas

premtimit të Tij, mund ta dish se Jezui jeton në ty. Ai ta dha jetën e përjetshme në çastin kur e ftove Atë në jetën tënde. Ai kurrë nuk do të të mashtrojë.

Edhe diçka tjetër që është me rëndësi për t'u mbajtur mend...

Mos u mbështet tek ndjenjat

Premtimi i Fjalës së Perëndisë, Biblës, është autoriteti ynë, dhe jo ndjenjat tona. Besimtari në Jezu Krisht jeton përmes besimit në karakterin e vetë Perëndisë dhe në vërtetësinë e Fjalës së Tij. Ky diagram në formën e trenit ilustron lidhjen ndërmjet **faktit** (Perëndia dhe Fjala e Tij), **besimit**, (besimi në Perëndinë dhe në Fjalën e Tij) dhe **ndjenjave** (që janë rezultati i besimit dhe bindjes ndaj Tij).



Treni tërhiqet prej lokomotivës dhe jo prej vagonit të fundit. Vagoni i mesit mban lëndën djegëse që duhet hedhur në lokomotivë, përndryshe treni nuk do të ecë. Në të njëjtën mënyrë, ne si besimtarë nuk mbështetemi në ndjenjat dhe emocionet tona, por në vetë Perëndinë dhe premtimet përmes Fjalës së Tij (*Gjoni 14:21*).

Tani që ke pranuar Jezuin

Kur pranove Jezuin me besim si shprehje e vullnetit personal, ndodhën shumë gjëra. Disa nga ato janë:

1. Jezui hyri në jetën tënde (*Zbulesa 3:20; Kolosianëve 1:27*).
2. Mëkatet t'u falën (*Kolosianëve 1:14*).
3. U bërë fëmijë i Perëndisë (*Gjoni 1:12*).
4. T'u dha jeta e përjetshme (*Gjoni 5:24*).
5. Fillove të zbulosh planin e madh që ka Perëndia për jetën tënde (*Gjoni 10:10; 2 Korintasve 5:17; 1 Selanikasve 5:18*).

A ka gjë më të mrekullueshme se sa pranimi i Jezuit si Zot? A dëshiron ta falënderosh Perëndinë përmes lutjes për atë që ka bërë për ty? Duke e falënderuar ti shpreh besimin tënd.

Sugjerime për rritjen shpirtërore

Rritja shpirtërore është rezultati i besimit te Jezui. "I drejti do të rrojë me anë të besimit" (*Galatasve 3: 11*). Një jetë e mbushur me besim tek Jezui do të të bëjë t'i besosh Perëndisë gjithnjë e më shumë, të mbështetesh tek Ai për çdo detaj të jetës tënde dhe të praktikosh hapat e rritjes si më poshtë:

- Referoju Fjalës së Perëndisë, lexoje atë çdo ditë (Veprat 17:11). Fillo me Ungjillin sipas Gjonit.

Katër Ligjet Shpirtërore

- Rehatuesi-Lejo Shpirtin e Shenjtë të të udhëheqë dhe të të japë fuqi për jetën dhe dëshminë tënde të përditshme (*Galatasve 5:16,17; Veprat 1:8*).
- I besoj Perëndisë për çdo detaj të jetës tënde (*1 Pjetrit 5:7*).
- Tregoj të tjerëve për Jezuin përmes jetës dhe fjalëve të tua (*Mateu 4:19; Gjoni 15:8*).
- Jepju Perëndisë në mënyrë të vazhdueshme duke iu bindur Fjalës së Tij (*Gjoni 14:21*).
- Afrohu çdo ditë tek Perëndia duke iu lutur Atij (*Gjoni 15:7*).

Miqësia me besimtarë të tjerë:

Fjala e Perëndisë na këshillon që të mos harrojmë të mblidhemi së bashku (*Hebrenjve 10:25*). Kur janë shumë trungje bashkë ato digjen fare mirë, por po ta veçojmë një nga trungjet ai shpejt do të shuhet. E njëjta gjë ndodh edhe në marrëdhënien tënde me besimtarë të tjerë. Nëse nuk je pjesëtar i ndonjë bashkësie, mos prit të të ftojnë. Merre vetë inicitivën; tako pastorin e një bashkësie të krishterë ku nderohet Krishti dhe predikohet Fjala e Tij. Fillo të shkosh që këtë javë dhe bëhu pjesëtar i rregullt i saj.

Materiale të veçanta për rritje në besim

Nëse arrite ta njohësh Krishtin përmes këtij prezantimi të ungjillit, na shkruaj për materiale të tjera që do të të ndihmojnë të rritesh në besim.

*Për më shumë informacion dhe për të ndarë
mendimin tënd mbi këtë libër na kontakto:*

Adresa postare:

Botimet Jeta e Re, K.P. 2420/1, Tiranë, Shqipëri.

www.kurbani.jezusi.org

E-mail: qengjikurbanit@gmail.com

"...Tashmë u mbushën 19 vjet që nga koha kur unë kam kuptuar të vërtetën e rëndësishme që ky libër përpiqet të tregojë. Kjo ka shkaktuar një furtunë transformuese në jetën time, duke më sjellë në disa brigje që nuk e dija se ekzistonin..."

"...Në fakt, e vërteta është edhe fokusi i këtij libri të vogël. Më saktë, e vërteta thelbësore e jetës njerëzore që është një e vërtetë kaq befasuese, kaq e pabesueshme, kaq e thjeshtë dhe tronditëse, sa mund të sjellë revolucion në çdo jetë njerëzore me pasoja të mrekullueshme..."

"...Asnjë njeri nuk ka monopolin mbi të vërtetën apo di gjithçka për të vërtetën. Të gjithë jemi bashkudhëtarë në një botë ku e vërteta zbulon vetveten dhe as nuk shpiket nga dikush e as mund të asgjësohet nga askush, prandaj le të ulemi e të bisedojmë si miq e pastaj të vazhdojmë në rrugën tonë në këtë botë të mahnitshme ku ka vend për të gjithë..."

Ylli H. Doçi ka kryer studimet për skulpturë në Liceun Artistik dhe pastaj në Akademinë e Arteve në Tiranë. Në vitin 2003 mbaroi studimet në Seminarin e Denverit, SH.B.A. me titullin Master i Arteve në Filozofinë e Religjionit, me çmime nderuese si "Who's Who?" (*Kush është dikush?*) në Universitetet Amerikane për vitin 2003. Nga viti 2006 shërben si Drejtor Kombëtar për Institutin Jeta e Re në Shqipëri dhe Kosovë.

ISBN: 978-99956-851-0-2



Çmimi: 200 Lekë

BOTIMET
Jeta e Re

